



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN  
E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 2060/3 Prot

Tiranë, më 11.09.2025

**VENDIM**

**Nr . 28, datë 11.09.2025**

**PËR  
URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

**KONSTATOVA SE:**

Ankuesi z. (në vijim “ankuesi”), ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) formularin e ankesës me nr. 2060 prot., datë 18.08.2025, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik/Bashkia Malësia e Madhe (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, me anë të kërkesës së datës 20.07.2025, depozituar në adresën elektronike [bashkiamalesiaemadhe@hotmail.com](mailto:bashkiamalesiaemadhe@hotmail.com), ka kërkuar t'i vendoset në dispozicion informacioni/dokumentacioni, për vitin 2024 në lidhje me:

1. *Listën e HEC-eve (emrat e tyre, lumenjtë dhe degët lumenjve mbi të cilat po ndërtohen, apo operojnë) që ndodhen në territorin e bashkisë?*
2. *Njësitë Administrative (apo fshatrat) në të cilat janë vendosur këto HEC-e?*
3. *Njësitë administrative (apo fshatrat) në të cilat janë vendosur panelet fotovoltaike (nëse ka)?*
4. *Njësitë Administrative (apo fshatrat) në të cilat janë vendosur turbinat e erës (nëse ka)?*
5. *Ju lutem të specifikoni HEC-et që ndodhen (apo kalojnë) brenda territoreve të zonave të Mbrojtura?*
6. *Një listë të zërave të të ardhurave që merr bashkia nga një HEC që operon në territorin e saj (Psh., a merr taksë mbi pasurinë e paluajtshme, taksë për ndërtesa, taksë trualli, taksë tabele, të ardhura nga qiratë për troje, taksë ujësjellës kanalizime, tarifë vendore për hecin ujqor, tarifë pastrimi dhe largimi të*

*mbeturinave, tarifë për dhënie me kontratë qiraje nga fondi pyjor dhe kullosor, tarifë e shërbimit administrativ, tarifë e shërbimeve që kryen struktura e mbrojtjes nga zjarri, tarifë e mirëmbajtjes së infrastrukturës rrugore?)?*

7. *Sa ishin të ardhurat e grumbulluara nga operimi i HEC-eve në vitin 2024?*
8. *Keni vendosur ndonjë taksë për dëmin që shkakton veprimtaria e HEC-it në mjedis? Nëse po, në ç'kushte aplikohet, ç'vlerë ka? Sa ishte vlera e përgjithshme që u përfitua për vitin 2024?*
9. *Sa është sipërfaqja e përgjithshme që sipas kërkesës së kompanive koncensionare (në hektar) është hequr nga fondi pyjor dhe kullosor dhe është vënë në dispozicion të projekteve të ndërtimit të HEC-eve (apo të paneleve diellore dhe të turbinave të erës, nëse ka)?*
10. *Sa nga kjo sipërfaqe i takon paneleve fotovoltaike dhe sa i takon turbinave të erës (nëse ka)?*
11. *A ka bashkia marrëveshje me secilën prej kompanive koncensionare, lidhur me përmbushjen e detyrimeve të marra përsipër nga kompanitë në fjalë, mbi zbatimin e angazhimeve të marra në favor të komunitetit, apo të mjedisit natyror, me qëllim zbutjen e pasojave që mund të shkaktohen nga operimi i HEC-it? Nëse po, kërkoj kopje të këtyre marrëveshjeve.*
12. *A kanë banorët (në dijeninë tuaj, ndoshta përmes kryepleqve) marrëveshje të shkruar me kompanitë e HEC-eve, që mundëson përdorimin e përkohshëm të rrjedhës së ujit në favor të fermerëve vendas gjatë sezonit të vaditjes? Nëse po, ju lutem nga një kopje të marrëveshjeve.*
13. *Kopje të plotë të realizimit të buxhetit për vitin 2024, që përfshin realizimin e të ardhurave dhe realizimin e shpenzimeve.*

Në mungesë të një përgjigje nga Autoriteti Publik, ankuesi, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ka paraqitur ankim pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji, konkretisht, urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të kërkuar sipas kërkesës për informacion datë 20.07.2025.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”).

Në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Komisioneri nëpërmjet shkresës nr. 2060/1 prot., datë 19.08.2025, ka kërkuar nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin, apo procedurën e ndjekur, lidhur me kërkesat për informacion, si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Në vijim të shkresës së sipërcituar, Autoriteti Publik nuk ndërmori asnjë masë për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar.

Ankuesi ka vijuar ankimin e tij nëpërmjet e-mail-it të datës 01.09.2025, rregjistruar pranë Zyrës së komisionerit me nr. 2060/2 prot., datë 01.09.2025.

Në këto rrethana, pas shqyrtimit të objektit të ankimit si dhe konsultimit të legjislacionit përkatës, Komisioneri vlerëson se, informacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2 të LDI, sipas të cilit *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*”.

Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar.

Autoriteti Publik, për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar, duhet të mbajë në konsideratë parashikimin sipas pikës 6 të nenit 17 të LDI, ku përcaktohet se: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim*”.

Bazuar në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njëjësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj*”.

Në kuptim të këtij parashikimi, Bashkia Malësia e Madhe është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundur realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në pikën 1 të nenit 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. Në këtë kuptim, çdo autoritet publik pavarësisht nëse është në cilësinë e “prodhuesit” apo “mbajtësit” të informacionit, detyrohet të garantojë njohjen e publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë.*

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike.

Bazuar në pikën 3, të nenit 3 të LDI, *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit*”.

Zyra e Komisionerit vëren se informacioni/dokumentacioni i kërkuar nga ankuesi, lidhet ngushtësisht me gjendjen e mjedisit dhe si informacion/dokumentacion i tillë, e drejta për t’u informuar garantohej edhe nga konventa *“Për të drejtën e publikut për informacion, pjesëmarrje në vendim marrje dhe të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës, për çështje që*

*lidhen me mjedisin” (Konventa e Aarhusit), ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 8672, datë 26.10.2000, e cila në nenin 4 pika 1 parashikon se: “Çdo Palë do të sigurojë që, në përputhje me paragrafët e mëposhtme të këtij neni, autoritetet publike, në përgjigje të kërkesës për informacion mjedisor, ta bëjnë informacionin të disponueshëm, brenda kuadrit të ligjit kombëtar, përfshirë kopje të dokumentit aktual që përmban këtë informacion në rastet kur kërkohet dhe sipas nënparagrafit (b) më poshtë: Pa qenë nevoja për të deklaruar interesin për këtë informacion. Në formën e kërkuar në qoftë se: Nuk është e arsyeshme për autoritetet publike që ta bëjnë atë të disponueshëm në një formë tjetër, dhe në këtë rast ato do të japin arsyet përse e kanë bërë të disponueshëm në atë formë; ose Informacioni nuk është ndërkohë i disponueshëm për publikun në një formë tjetër.” dhe në pikën 2 të nenit të sipërcituar, shprehet se: “Informacioni mjedisor, referuar në paragrafin 1 më lart, do të bëhet i disponueshëm sa më shpejt që të jetë i mundur, por jo më vonë se një muaj pas paraqitjes së kërkesës, nëse volumi dhe kompleksiteti i informacionit e justifikon zgjatjen e kësaj periudhe deri në dy muaj mbas kërkesës. Kërkuesi i informacionit do të informohet për çdo shtyrje të afatit kohor dhe për arsyet që justifikojnë këtë shtyrje.”*

Gjithashtu, ankuesi është gazetar, i cili synon informimin e opinionit publik mbi çështje lidhur me funksionimin e autoriteteve publike, duke i shërbyer në këtë mënyrë interesit të lartë publik. Ky qëndrim i Komisionerit, gjen mbështetje në jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila në çështjen “*Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë*”, vlerësoi se, pengesat e krijuara, të cilat vështirësojnë aksesin në informacion me interes publik, mund të dekurajojnë punonjësit e medias, ose në fusha të ndërlidhura me të, të realizojnë punën e “*mbikëqyrësit shoqëror*”, duke zvogëluar mundësitë e tyre për të ofruar informacione të sakta dhe të besueshme.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

## **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

## **V E N D O S A:**

1. Pranimin e ankesës së z. \_\_\_\_\_, me nr. 2060 prot., datë 18.08.2025, ndaj Autoritetit Publik, Bashkia Malësia e Madhe me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 20.07.2025, konkretisht: “*Për vitin 2024: 1.Listën e HEC-eve (emrat e tyre, lumenjtë dhe degët lumenjve mbi të cilat*

- po ndërtohen, apo operojnë) që ndodhen në territorin e bashkisë? 2. Njësitë Administrative (apo fshatrat) në të cilat janë vendosur këto HEC-e? 3. Njësitë administrative (apo fshatrat) në të cilat janë vendosur panelet fotovoltaike (nëse ka)? 4. Njësitë Administrative (apo fshatrat) në të cilat janë vendosur turbinat e erës (nëse ka)? 5. Ju lutem të specifikoni HEC-et që ndodhen (apo kalojnë) brenda territoreve të zonave të Mbrojtura? 6. Një listë të zërave të të ardhurave që merr bashkia nga një HEC që operon në territorin e saj (P.sh., a merr taksë mbi pasurinë e paluajtshme, taksë për ndërtesa, taksë trualli, taksë tabele, të ardhura nga qiratë për troje, taksë ujësjellës kanalizime, tarifë vendore për hecin ujqor, tarifë pastrimi dhe largimi të mbeturinave, tarifë për dhënie me kontratë qiraje nga fondi pyjqor dhe kullosor, tarifë e shërbimit administrativ, tarifë e shërbimeve që kryen struktura e mbrojtjes nga zjarri, tarifë e mirëmbajtjes së infrastrukturës rrugore?). 7. Sa ishin të ardhurat e grumbulluara nga operimi i HEC-eve në vitin 2024? 8. Keni vendosur ndonjë taksë për dëmin që shkakton veprimtaria e HEC-it në mjedis? Nëse po, në ç'kushte aplikohet, ç'vlerë ka? Sa ishte vlera e përgjithshme që u përfitua për vitin 2024? 9. Sa është sipërfaqja e përgjithshme që sipas kërkesës së kompanive koncensionare (në hektar) është hequr nga fondi pyjqor dhe kullosor dhe është vënë në dispozicion të projekteve të ndërtimit të HEC-eve (apo të paneleve diellore dhe të turbinave të erës, nëse ka)? 10. Sa nga kjo sipërfaqe i takon paneleve fotovoltaike dhe sa i takon turbinave të erës (nëse ka)? 11. A ka bashkia marrëveshje me secilën prej kompanive koncensionare, lidhur me përmbushjen e detyrimeve të marra përsipër nga kompanitë në fjalë, mbi zbatimin e angazhimeve të marra në favor të komunitetit, apo të mjedisit natyror, me qëllim zbutjen e pasojave që mund të shkaktohen nga operimi i HEC-it? Nëse po, kërkoj kopje të këtyre marrëveshjeve. 12. A kanë banorët (në dijeninë tuaj, ndoshta përmes kryeqpleqve) marrëveshje të shkruar më kompanitë e HEC-eve, që mundëson përdorimin e përkohshëm të rrjedhës së ujit në favor të fermerëve vendas gjatë sezonit të vaditjes? Nëse po, ju lutem nga një kopje të marrëveshjeve. 13. Kopje të plotë të realizimit të buxhetit për vitin 2024, që përfshin realizimin e të ardhurave dhe realizimin e shpenzimeve.”, brenda datës 19.09.2025.*
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
  4. Ky vendim u shpall sot në datë 11.09.2025.

## **KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**